



### *VENDIM*

*Nr. 42 Datë 13.05.2014*

### PËR

### **FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SH.A NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “d” të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 8 dhe 10 pika 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 13.05.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

#### **Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.10 gërmat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a, për liçensim në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.